



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade
Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë

SKEMA E GRANTEVE

Udhëzues për aplikim: Thirrja publike për përkrahjen financiare të ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM) për blerjen e makinerive të avancuara prodhuese dhe përpunuese.

Autoriteti kontraktues dhe zbatues: Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), respektivisht Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA).

1. Hyrje

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), lanson skemën e granteve për mbështetjen e NMVM-ve për blerjen e makinerive të avancuara prodhuese dhe përpunuese, me qëllim të transformimit strukturor drejt një industrie më të integruar globalisht, e cila është në gjendje të prodhojë produkte me vlerë të lartë të shtuar.

2. Qëllimi

Qëllimi i skemës së grantit është të ndihmojë NMVM-të që të kontribuojnë në rritjen e prodhimit dhe përpunimit, përmes zgjerimit të kapaciteteve prodhuese, rritjes së pjesëmarrjes së produkteve në tregun vendor dhe rritjes së eksportit, që autputi përfundimtar i kësaj skeme është përmirësimi i bilancit tregtar. Gjithashtu, synon të nxisë rritjen e punësimit dhe të inkurajojë bizneset të kontribuojnë dhe të përfitojnë përmes ekonomisë qarkore. Përparësi të kriteret e vlerësimit, kanë NMVM-të me vlerë të shtuar në prodhim dhe me orientim për eksport.

3. Sektorët e pranueshëm për të aplikuar sipas kodeve NACE

Kodi 10	Përpunimi i Produkteve Ushqimore
Kodi 11	Prodhimi i Pijeve
Kodi 13, 14 dhe 15	Prodhimi i Tekstilit, Veshjeve dhe Lëkurës
Kodi 16	Prodhimi i Drurit dhe i Produkteve të Drurit
Kodi 31	Prodhimi i Mobileve
Kodi 17	Prodhimi i Letrës dhe Produkteve prej Letrës
Kodi 21	Prodhimi i Produkteve bazë dhe Preparateve Farmaceutike
Kodi 22	Prodhimi i Produkteve të Gomës dhe Plastikes
Kodi 23	Prodhimi i Produkteve Minerale jo Metalike
Kodi 24	Prodhimi i Metaleve
Kodi 25	Prodhimi i Produkteve të Fabrikua Metalike
Kodi 27	Prodhimi i Pajisjeve Elektrike.

Përkrahja financiare e ofruar nga MINT/KIESA

Shuma totale e grant skemës është 5,000,000€. MINT/KIESA rezervon të drejtën të mos shpërndajë të gjitha mjetet në dispozicion. Grantet planifikohen të ndahen përmes tre kategorive si në vijim:

1. **Kategoria 1:** Ndërmarrjet mikro, deri në 9 të punësuar, mund të përfitojnë një vlerë maksimale deri në 40,000€. Buxheti për këtë kategori është 2,000,000€. Numri i ndërmarrjeve përfituese planifikohet të jetë 50. Në këtë kategori, bashkëfinancimi nga bizneset duhet të jetë jo më pak se 30% e vlerës së projektit.
2. **Kategoria 2:** Ndërmarrjet e vogla, me 10 deri në 49 të punësuar, mund të përfitojnë një vlerë maksimale deri në 80,000€. Buxheti për këtë kategori është 2,500,000€. Numri i ndërmarrjeve përfituese planifikohet të jetë 31. Në këtë kategori, bashkëfinancimi nga bizneset duhet të jetë jo më pak se 40% e vlerës së projektit.
3. **Kategoria 3:** Ndërmarrjet e mesme, me 50 deri në 249 të punësuar, mund të përfitojnë një vlerë maksimale deri në 120,000€. Buxheti për këtë kategori është 500,000€. Numri i ndërmarrjeve përfituese planifikohet të jetë 4. Në këtë kategori, bashkëfinancimi nga bizneset duhet të jetë jo më pak se 50% e vlerës së projektit.

Sqarim: Në rast që nuk plotësohet kuota në ndonjërin nga kategoritë, atëherë teprica e buxhetit mund të bartet në kategoritë e tjera.

4. Dokumentet e kërkuara për aplikim sipas Udhëzimit Administrativ 01/2018

1. Certifikatën e regjistrimit të biznesit me të gjitha informatat përcjellëse sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.
2. Certifikatën e numrit fiskal (nuk aplikohet për bizneset të cilat numrin e regjistrimit të biznesit dhe numrin fiskal e kanë në një certifikatë).
3. Vërtetim tatimor me të cilën vërtetohet se aplikuesi nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime tjera tatimore ose është në marrëveshje për shlyerjen e borxhit me ATK.
4. Listën e punëtorëve për vitin 2024 të lëshuar nga ATK me emrin e biznesit aplikues në harmoni me NUI (mund të nxjerrët online nga ueb faqja e ATK-së). Në bazë të listës do të kategorizohen dhe vlerësohen NMVM-të dhe do të vlerësohen piket e punësimit të gjinisë femërore. Për bizneset e regjistruara gjatë vitit 2024 dhe 2025 duhet të sjellin listën e punëtorëve që nga regjistrimi.
5. Kopjen e letërnjoftimit të personit/ve në emër të cilit/ve është i regjistruar aplikuesi.
6. Dëshmi nga aplikuesi se nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor të lëshuar nga Gjykata Themelore - kërkohet origjinali jo më i vjetër se 30 ditë. Dokumenti mund të nxirret në Gjykatën Komerciale të Kosovës.
7. Dëshminë e xhirollogarisë aktive në emër të biznesit aplikues në njërin prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës. Dëshmia duhet të jetë brenda afatit të hapjes së thirrjes.
8. Gjendjen e xhirollogarisë bankare në emër të biznesit aplikues për vitin e fundit (2024). Për aplikuesin e sapo themeluar kjo nuk është e aplikueshme.
9. Oferta për makinerinë prodhuese dhe përpunuese nuk duhet të jetë më e vjetër se data e shpalljes së kësaj thirrje. Makineria duhet të jetë e re dhe nuk lejohet të shitet brenda 3 viteve. Makineria duhet të këtë markimin/shenjen CE e dëshmuar me Deklaratën e Konformitetit. Përparësi kanë makineritë e blera nga vendet e Bashkimit Evropian. E gjithë kjo do të jetë pjesë e marrëveshjes së bashkëfinancimit.

10. Të mos ketë pranuar mjete nga burimet tjera të financimit për të njëjtat aktivitete (e dëshmuar me deklaratë nën betim, e cila duhet shkarkuar nga ueb faqja e KIESA-se, të plotësohet me të dhënat e biznesit dhe e njëjta të ngarkohet në sistemin e-Kosova).
11. Të kenë kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit nga MINT për dy vitet e fundit, (e dëshmuar me deklaratë nën betim, e cila duhet shkarkuar nga ueb faqja e KIESA-se, të plotësohet me të dhënat e biznesit dhe e njëjta të ngarkohet në sistemin e-Kosova).
12. Për bizneset e regjistruara para vitit 2023, duhet të sjellin qarkullimin për vitin 2023 dhe 2024 i dëshmuar me dokument të lëshuar nga ATK. Për bizneset e regjistruara gjatë viteve 2023 dhe 2024 duhet të sjellin qarkullimin total që nga regjistrimi. Ndërsa, për bizneset e regjistruara gjatë vitit 2025 duhet të sjellin qarkullimin total që nga regjistrimi.
13. Për bizneset eksportuese, bizneset e regjistruara para vitit 2023, duhet të sjellin vërtetimin e eksportit për vitin 2023 dhe 2024 i dëshmuar me dokument të lëshuar nga Dogana e Kosovës. Për bizneset e regjistruara gjatë viteve 2023 dhe 2024 duhet të sjellin vërtetimin e eksportit që nga regjistrimi. Ndërsa, për bizneset e regjistruara gjatë vitit 2025 duhet të sjellin vërtetimin e eksportit që nga regjistrimi (kjo nuk është diskualifikuese dhe vlen vetëm për bizneset që eksportojnë).
14. Projekt propozimi duhet të përfshijë: qëllimin, aktivitetet e projektit duke përfshirë këtu karakteristikat kryesore të gjelbra dhe praktikave të ekonomisë qarkore, koston financiare, planin kohor të realizimit të projektit, strukturën organizative të aplikuesit dhe objektivat e kompanisë dhe plani konkret për zhvillimin e projektit. Ky projekt propozim duhet të plotësohet online në e-Kosova.
15. Aplikacioni, projekt propozimi dhe buxheti, të plotësohen online në e-Kosova.

Sqarim:

- Kategoria 1 dhe 2 (deri në 49 punëtorë), në mungesë të cilitdo dokument të kërkuar më lart, me përjashtim të kriterëve numër 2 (Certifikatën e numrit fiskal) dhe 13 (vërtetimi i eksportit), do të diskualifikohen.
- Kategoria 3 (nga 50 deri në 249 punëtorë), në mungesë të cilitdo dokument të kërkuar më lart, me përjashtim të kriterit numër 2, do të diskualifikohen.

5. Sqarime shtesë

- Aplikacionet mund të plotësohen në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.
- NMVM-të që gjatë vitit 2022, 2023 dhe 2024 kanë përfituar mjete financiare direkt nga MINT/KIESA në grant skemat për blerjen e makinerive prodhuese dhe përpunuese, inovacion dhe artizanate, nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga kjo thirrje. Ndërsa, brenda vitit 2025 kompania e njëjtë nuk mund të jetë përfituese në ndonjë grant skemë tjetër të KIESA-së.
- Në rast që ndërmarrja do të jetë përfitues, atëherë do të nënshkruhet marrëveshje dypalëshe (MINT/KIESA dhe ndërmarrje), pjesë e secilës do të jenë edhe deklaratimet që janë bërë me rastin e aplikimit.
- Fushë veprimtaria primare ose sekondare e ndërmarrjeve duhet të jetë në harmoni me nën sektorët sipas klasifikimit të kodeve NACE nga sektorët e pranueshëm, sipas thirrjes dhe nuk pranohet ndryshimi i tyre në ARBK gjatë fazës së aplikimit të thirrjes publike. Po ashtu, për bizneset përfituese pas shpalljes së listës preliminare deri të realizimi i pagesës nuk lejohet asnjë ndryshim në ARBK.

- Para nënshkrimit të marrëveshjes, ndërmarrjet përfituese obligohen me sjell garancion nga kompanitë e sigurimit apo nga bankat, për vlerën totale të grantit.
- Pas nënshkrimit të marrëveshjes, ndërmarrjes përfituese do t'i transferohen 100% e vlerës së aprovuar.
- TVSH është shpenzim i pranueshëm për persona fizik dhe ndërmarrjet jo deklaruese të TVSH-së, ndërsa për ndërmarrjet që janë deklaruese të TVSH-së, ky është shpenzim i papranueshëm.
- Përfitues do të jenë ndërmarrjet që janë renditur më pikë më të larta nga komisioni vlerësues. Varësisht nga limitet buxhetore, lista e bizneseve përfituese mund të parasheh deri në 10 biznese rezervë.
- Ndryshimi i ofertës mund të bëhet vetëm me kërkesë të veçantë e cila parashtrohet në MINT/KIESA, respektivisht në komisionin monitorues. Kërkesa duhet të mbështetet në arsye të qëndrueshme nga përfituesi dhe e njëjta mund të implementohet vetëm pas miratimit të kërkesës dhe nuk ndryshohet koncepti i projektit dhe shuma e grantit nga Ministria. Në rastet kur kemi ofertues me çmime më të larta se ato të prezantuara në projektin aplikues, atëherë ndryshimet e çmimeve janë obligim i përfituesit dhe në asnjë rast nuk ndryshon vlera e grantit nga Ministria.
- Në ueb të MINT/KIESA do të publikohet lista e ndërmarrjeve të vlerësuara.
- Grant skema ka për qëllim mbështetjen direkte të bizneseve prodhuese dhe përpunuese dhe inkurajon ngritjen e kapaciteteve profesionale brenda kompanive, të cilat synojnë të rrisin prodhimin dhe eksportin e tyre që kontribuojnë dhe orientojnë modelet e tyre të bizneseve drejt karakteristikave kryesore të gjelbra dhe praktikave ekonomike qarkore duke përfshirë këtu eficienten e energjisë, zgjatjen e ciklit të jetës së produkteve, si dhe adaptimin dhe respektimin e standardeve për ruajtjen e ambientit dhe reduktimin e mbetjeve. Prandaj, me këtë thirrje përjashtohen nga ky proces kompanitë konsulente që ofrojnë shërbime për bizneset aplikuese. Në rast të identifikimit të përfshirjes së tyre si përfaqësuese të bizneseve, aplikuesit do të diskualifikohen. Kjo, për arsye se i gjithë procesi është i thjeshtë dhe pa kosto financiare, duke filluar nga mënyra elektronike e aplikimit përmes platformës e-Kosova, e deri të vlerësimi, nënshkrimi i marrëveshjeve, disbursimi i mjeteve dhe monitorimi i tyre.
- Bizneset përfituese gjatë procesit të monitorimit, makinerinë duhet ta dëshmoj me faturë origjinale ose Dud doganor origjinal.

6. Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e planifikuar maksimale për realizimin e plotë të projektit që financohet nga MINT/KIESA është 12 muaj, që nga nënshkrimi i kontratës ndërmjet palëve dhe nuk do të ketë aftat shtesë. Bizneset obligohen të raportojnë së paku 30 ditë para skadimit të marrëveshjes.

7. Si të aplikohet

- Njoftimi për thirrje publike është i publikuar në ueb faqen zyrtare të MINT dhe të KIESA-së:
 ☞ <https://mint.rks-gov.net/>
 ☞ <http://kiesa.rks-gov.net/>
- Aplikimi bëhet vetëm në mënyrë elektronike përmes platformës e-Kosova dhe nuk pranohet në ndonjë formë tjetër.

- Afati për dorëzimin e aplikacionit dhe dokumenteve përcjellëse është nga data 05.05.2025 deri më datë 26.05.2025.
- Informatat shitesë mund të merren përmes email adresës: sme.kiesa@rks-gov.net

#	8. Kriteret e vlerësimit	Pikët maksimale		
		Kategoria 1	Kategoria 2	Kategoria 3
1	Vlerësimi i projekt propozimi ¹	35	35	35
2	Vlerësimi i qarkullimit vjetor ndërmjet aplikueseve, sipas pikës 12 të nenit 5 të këtij udhëzuesi	15	15	15
3	Vlerësimi i rritjes së qarkullimit brenda kompanisë, krahasuar ndërmjet viteve sipas pikës 12 të nenit 5 të këtij udhëzuesi	10	10	10
4	Vlerësimi i eksportit ndërmjet aplikuesve, sipas pikës 13 të nenit 5 të këtij udhëzuesi	10	10	10
5	Vlerësimi i rritjes së eksportit brenda kompanisë, krahasuar ndërmjet viteve, sipas pikës 13 të nenit 5 të këtij udhëzuesi	10	10	10
6	Përqindja e të punësuarve të gjinisë femërore, nga një (1) pikë për çdo 10% të të punësuarve të gjinisë femërore.	10	10	10
7	Rritja e punësimit	Nga pesë (5) pikë për çdo një (1) që do të punësoj	Nga 3.33 pikë për çdo një (1) që do të punësoj	Nga dy (2) pikë për çdo një (1) që do të punësoj
		10	10	10

9. Ankesat

Pas publikimit të rezultateve preliminare, aplikuesit mund të adresojnë ankesa brenda afatit të paraparë me UA 01/2018, vetëm në platformën e-Kosova.

Shënim: Në rast se informatat e dhëna në këtë aplikacion vërtetohen që janë të pa sakta, biznesit nuk do t'i realizohet pagesa dhe i njëjti do të mbaj përgjegjësi për të gjitha pasojat, sipas legjislacioneve relevante në fuqi.

¹ Të paraqiten në projekt propozim, qëllimi, aktivitet e projektit, kosto financiare, plani kohor i projektit, strukturën organizative të aplikuesit, kapacitetet aktuale prodhuese dhe synimet e rritjes së prodhimit dhe eksportit, apo zëvendësimit të importit në rast të përfitimit të grantit, rëndësia e propozimit me prioritetet e thirrjes, sektorët dhe specifikat e tjera, sa i adreson propozimi i projektit pengesat strukturore të atij sektori, çfarë vlere të shtuar ka projekti për vendin, sa janë aktivitetet e realizueshme dhe të qëndrueshme në lidhje me rezultatet e pritshme dhe rreziqet e mundshme, si dhe mënyra e implementimit. Vlerësohen lartë bizneset që synojnë të rrisin prodhimin dhe eksportin e tyre, dhe të kontribuojnë dhe orientojnë modelet e tyre të bizneseve drejt karakteristikave kryesore të gjelbra dhe praktikave ekonomike qarkore duke përfshirë këtu eficienten e energjisë, zgjatjen e ciklit të jetës së produkteve, si dhe adaptimin dhe respektimin e standardeve për ruajtjen e ambientit dhe reduktimin e mbetjeve. Ky projekt propozim duhet të plotësohet online në e-Kosova. Për aplikuesit, deklarimet në projekt propozim, në rast të përfitimit, do të reflektohen në marrëveshjen mes palëve. Nëse gjatë procesit vërtetohet se janë paraqitur informacione ose të dhëna të rreme apo të pasakta, biznesi do të diskualifikohet dhe lënda do të procedohet më tej sipas ligjeve në fuqi.